



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 16656 Prot.

Lezhë, më 2 . 11 . 2023

VENDIM

Nr. 61, Datë 31. 10. 2023

PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI”

Z. SALVATOR GJEÇI

Mbështetur në Ligjin 139/2015, datë 17.12. 2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak” Pika “m” dhe Ligjit Nr. 112/2013 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë Të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, neni 16, pika 1, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi:

1. T’i jepet titulli “Qytetar Nderi” Z. **Salvator Gjeçi** me motivacionin: “Për kontributin e dhënë në fushën e letërsisë, në jetën artistike në Lezhë dhe në mbarë trojet shqiptare”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI



Prot 166576/  
DT 8.11.23



CB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 501/32 Prot.

Lezhë, më 07.11.2023

Lënda: **Konfirmim vendimi**

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2, germa "b", të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", nenin 9, pika 1.1, germa "b" dhe pika 1.7, germa "a", nenin 54, germa "m", si dhe nenin 55 pika 2, të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në ligjin nr.112/2013 "Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.61, datë 31.10.2023, të këshillit të bashkisë Lezhë, për "Dhënien e titullit "Qytetar Nderi" z.Salvator Gjeçi".

**P R E F E K T I**

**Gjergj PRENDI**

